REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC PF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE, PROSTORNONG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: ARPL
Nr.i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 2537-2/23
Nr.i Faqeve / Br. Stranica / No.Pages: 04.
Data / Datum / Date: 04.03.24
PRISHTINË / A No.1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry of Environment, Spatial Planinng and Infrastructure***

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secratary*

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 15.02.2024 |
| REFERENC-Ë: | 2537/23- ARPL |
| PËR/ZA/TO: | „I.M.N Tulltorja" SH.P.K., Landovicë- Prizren |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Z. Izedin BYTYQI- Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së<br><br>Z. Naser HAFIZI- Zëvendësues i Udhëheqësit të ARPL-së |
| NGA/OD/FROM: | Myrvete Mulaj - Zyrtare përgjegjëse për akte ujore |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim – Pëlqim Ujor, Shkarkim |

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shqyrtuar kërkesën me Nr. të protokollit: 2537/23, dt.12.05.2023, për **shkarkim,** Fabrika e prodhimit të bllokave dhe produkteve nga argjila **„I.M.N Tulltorja"** SH.P.K., Landovicë- Prizren dhe ka vendosur si në Vendimin për Pëlqim Ujor, pas plotësimit të dokumentacionit të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Adresa: ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 558
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Nr. P.U.11
Datë: 15.02.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjenive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mejdisit, Planifikimnit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

**PËLQIM UJOR**
**( Për hartimin e dokumentacionit-tekniko investiv, për Leje Ujore për ITUN – Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura nga fabrika për prodhimin e bllokave dhe produkteve nga argjila)**

**APROVOHET** kërkesa për **Pëlqim Ujor** për palën **„I.M.N Tulltorja" SH.P.K., Landovicë- Prizren, me Nr. prot. 2537/23**, , sipas projektit ideor për shkarkimin e ujërave të ndotura në pikën me koordinata **X = 4682317.69 ; Y =7473706.26, nga fabrika për prodhimin e bllokave dhe produkteve nga argjila,** sipas dokumentacionit investivo teknik të dorëzuar, nën kushtet si në vijim:
; sipas kushteve vijuese:

**Aplikacionit për leje ujore duhet bashkangjitur edhe:**

- Kopja e vendimit mbi lejimin e ndërtimit;
- Kopja e vendimit të Pëlqimit Ujor;
- Projekti i gjendjes së zbatuar;
- Rregullore (akt i përgjithshëm ) mbi mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe vëzhgimin e objekteve ujore dhe sjelljen në rast të dëmeve dhe avarive;



Adresa: ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 558
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

- Programin e aprovuar të monitorimit dhe raportimit ( periodik ose vjetor 0) mbi testimin dhe vlerësimin e kualitetit të ujërave të ndotura;
- Përshkrimi i zgjidhjes, respektivisht procesit teknologjik të aktivitetit ;
- Vlerësimi i sasive dhe llojit të ujërave të ndotura, te përfshihen ne projekt;

- Shkalla e nevojshme e pastrimit dhe koncepti i zgjidhjes teknike të impiantit për pastrimin e ujërave të ndotura për arritjen e kritereve të kualitetit të ujit të recipientit gjatë prurjes meritore, të cilat duhet bazuar në "U.A. MMPH –Nr. 02/2022 për kushtet, mënyra, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor"
- Detyrohet pala për eliminim dhe kompensim në rast të dëmeve të shkaktuara personave të tretë, gjatë zhvillimit të aktiviteteve në kohën e validitetit të pëlqimit ujor;
- Vlefshmëria e pëlqimit ujor është 6 ( gjashtë ) muaj nga data e lëshimit të tije, nëse deri në këtë datë nuk është siguruar leja ndërtimore dhe fillimi i punimeve të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza (ITUZ) për destinimin tuaj përkatës;
- Pala nuk sanksionohet nga pagesa, sipas parimit "Ndotësi paguan" që do të thotë se, çdo person që shkakton apo lejon shkarkime të ndotjes do të përgjigjet financiarisht, sipas U.A për strukturën e pagesave në fuqi .
- Për këtë pala duhet të raportoj në MMPHI për sasinë e shkarkimit çdo gjashtë muaj, për të plotësuar kushtin si më sipër.

**Arsyetim**

Zyrtarja përgjegjëse, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim për Leje ujore - shkarkimi i ujit nga fabrika e prodhimit të betonit dhe produkteve nga argjila, bashkangjitur Dokumentacioni i kompanisë, Çertifikata e Regjistrimit te Biznesit -ARBK - "I.M.N Tulltorja" Sh.p.k, Pelqim nga komuna me nr.334/47, dt.02.01.2021, Pëlqimi për ushtrimin e veprimtarisë , Nr.334/47, dt.02.01.2021Çertifikatë e pronësisë, Kopja e Planit, Koordinatat, Elaborati i punuar nga ndërmarrja projektuese "ALBI & B " Sh.p.k., plani i situacionit në përpjesë të lexueshme, i nënshkruar dhe i vulosur nga Ardit B. Bytyqi, gjeodet i licencuar ,
Situacioni i terenit 1:1250, CD.
Fatura e pagesës, Leje Ujore.

Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Adresa: ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 558
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 2537/23 Datë: 12.05.2023

Prishtinë

T'i dërgohet :
- Palës;
- Zyrës se Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së
- Inspektoratit të MMPHI-së
- Komunës Prizren;
- Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së

Izedin BYTYQI



Adresa: ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 558
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net